



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05-350/02-115525/24 dt.02.09.2024, të kërkuarit: RIT Kosovo (A.U.K.) College, Adresa: Gërmia Campus, Nazmi Gafurri, 21 Dr. Shpëtim Robaj, Prishtina 10000, Kosovë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës multifunkionale, në kuadër të kampusit RIT, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 2411-0 dhe 2410-1 ZK. Prishtinë, të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia 2016-2024" Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 15.11.2024 deri më 30.11.2024, në e-mail adresën: urbanizimprishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me etazhitet B+P+4
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~50 m`
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	Fasadat primare që kanë dritare të ndriçimit dhe ajrosjes duhet të jenë 0.5 e lartësisë së objektit, të larguara nga kufiri i parcelës së vet, ndërsa ato sekondare 0.2 e lartësisë
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=30% e lejuar Përdhesa e propozuar 886.19 m ²
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN e propozuar P+4
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60%, e lejuar Bodrumi i propozuar 888.06m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	Institucionet shkollore duhet të kenë 2 vendparkingje për 100m ² të ndërtesës;
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

